



KOMUNIKATË

30. 09. 2009

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e vetë të 36-të të mbajtur dje, ka shqyrtuar rekomandimet e Zyrës për Regjistrim të Partive Politike për certifikim. Drejtoresha e ZRPP-së, Miradije Mavriqi, i paraqiti rekomandimet për certifikim për 25 subjekteve politike të cilat janë proceduar nga zyrja dhe mbi këtë bazë, këto subjekte kanë plotësuar kushtet e parapara me ligj që të certifikohen. KQZ, miratoi rekomandimet e zyrës dhe i certifikoi këto subjekte, prej të cilave 20 janë parti politike, 4 janë inisiativa qytetare dhe, 1 koalicion.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me këtë ka përfunduar punën e certifikimit. Numri i subjekteve në total që janë certifikuar nga KQZ dhe që do të marrin pjesë në zgjedhje, është 74.